



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 42 Akti

Nr. 30 Vendimi

Tiranë, më 03.07.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupës gjyqësore të përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Xhensila Pine	Anëtare
Etleda Çiftja	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, Znj. Anisa Duka, dhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko Hrvatit, sot më datë 03.07.2018, ora 15:00, në katin e dytë, pranë Pallatit të Kongreseve zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

Subjektit të Rivlerësimit: **Z. Vatë Staka**, prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D** të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT, pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, Znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, vëren:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. **Z. Vatë Staka është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër** bazuar në nenin 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”).
2. Në bazë të pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës, duke qenë se Z. Vatë Staka, ka kandiduar për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit menjëherë, duke u shortuar më datë 30 nëntor 2017 me trupë gjyquese nr. 4, të përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Komisionere
Xhensila Pine	Komisionere
Etleda Çiftja	Relatore

3. Menjëherë me hedhjen e shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “**ILDKPKI**”), sipas neneve 31-33 të ligjit nr.84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “**DSIK**”), sipas ligjit 34-39 të ligjit nr.84/2016 dhe Grupi i Punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm (këtu e më poshtë referuar si “**GPPP**”), sipas neneve 40 – 44 të ligjit 84/2016.
4. **Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)** ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe **ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr.*** datë 13.11.2017**, të përbërë nga 14 fletë, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr.84/2016;
5. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, **DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën *** prot., datë 27.10.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr.84/2016;**
6. **Grupi i Punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr.84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, **ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën ***, datë 27.12.2017**, në prezencë të një antari të Komisionit të përzgjedhur me short z. Olsi Komici, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.84/2016.
7. **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “Komisioni”), me vendimin nr. 1, datë 12.12.2017**, të trupës gjyquese nr.4, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tre kriteret, (i) Vlerësimin e pasurisë; (ii) Kontrollin e figurës dhe (iii) vlerësimin profesional, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuesin e trupës, znj.Valbona Sanxhaktari të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
8. **Më datë 07.06.2018**, trupa gjyquese, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Z. Vatë Staka, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës për shpjegime të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016;

(iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

9. Më datë 07.06.2018, subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike për përbërjen e trupës gjyquese si dhe u njoftua se ka të drejtë të deklarojë konfliktin e interesit me anëtarët e trupës gjyquese. Subjekti i Rivlerësimit Vatë Staka, po në të njëjtën ditë ktheu përgjigje me anë të postës elektronike ku deklaroi se në dijeninë e tij , nuk ishte në konflikt interesi me asnjë prej komisionereve.

9.1 Më datë 08.06.2018, me anë të postës elektronike, trupa gjyquese njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës për të dhënë shpjegime sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me e-mail; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me e-mail;

10. Më datë 22.06.2018, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e tij së bashku me provat, të cilat u administruan nga ana e Komisionit.

11. Më datë 22.06.2018, trupa gjyquese nr. 4, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Z. Vatë Staka, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 25.06.2018, ora 15:00 pasdite, te Pallati i Koncerteve, kati i 2-të, Tiranë.

12. Më datë 25.06.2018, u zhvillua seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, Vatë Staka, ku ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Pasi Trupa gjyquese dëgjoji qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procesin e rivlerësimit, ndërpreu seancën dëgjimore për të rifilluar më datë 03.07.2018, për shpalljen e vendimit.

II. BASHKËPUNIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, SIPAS NENIT 48 TE LIGJIT NR. 84/2016

13. Gjatë të gjitha fazave të hetimit, trupa gjyquese ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Trupa gjyquese konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

14. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore më datë 25.06.2018. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 25.06.2018, ora 15:00 paradite, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko Hrvatin.

15. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ishte prezent, ai dha shpjegimet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, Z. Vatë Staka, kërkoi konfirmimin në detyrë.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke kryer procesin e rivlerësimit mbi bazën e 3 kritereve të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, si më poshtë vijon:
- a. Për vlerësimin e pasurisë;
 - b. Për kontrollin e figurës, dhe
 - c. Për vlerësimin e aftësive profesionale.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E VLERËSIMIT TË PASURISË:

Në lidhje me procesin e rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim bazuar në:

17. Raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit 84/2016

Me shkresën ***, datë 13.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Z. Vatë Staka, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi 1994 dhe në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr.84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” më datë 26.01.2017.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin Vatë Staka:

- a. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18. Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për rivlerësimin e kriterit të vlerësimit të pasurisë

Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Vatë Staka, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë.

Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, si dhe verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, si dhe deklaratimet e bëra me anë të postës elektronike e-mail, Komisioni ka administruar prova shkresore nga: *Institucionet financiare bankare dhe jobankare; Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme; Drejtoria e*

Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë; Instituti i Sigurimeve Shoqërore; Qendra Kombëtare e Biznesit; Ministria e Drejtësisë; Noteri Publik, për dokumentacion në lidhje me subjektin, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Krugor; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; shoqëri tregtare; Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), UKT etj. që vërtetojnë veprime dhe fakte për realizimin e hetimit sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi nga ana e Komisionit përfshiu verifikimin e të gjitha deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur/bashkëshortes të subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë:

19. Shtëpi banimi, në lagjen “****”, në Rr. “****”, rajoni nr. ***, Bashkia Shkodër, zona kadastrale nr. ***, pasuria nr. ***, sipërfaqja e tokës së parcelës ndërtimore është 300 m², sipërfaqe ndërtimi është 131.06 m². Shtëpia është ndërtuar në vitet 93 - 95, me kontributin e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij V.S. Burimi i të ardhurave: me të ardhurat e pagës së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes. Pjesa takuese 50%.

Hetimi kryesisht i kryer nga Komisioni u përqëndrua në vërtetimin e faktit, analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie dhe nëse këto burime ishin nga të ardhura të ligjshme në përputhje me ligjin.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër¹ (ZVRPPSH) konfirmon me anë të Certifikatës për vërtetim pronësie se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi pasurinë me nr. *** vol. *** fq. *** të ndodhur në Zonën Kadastrale nr. ***, ndodhur në Shkodër, lloji i pasurisë 300 (treqind) m² truall, ku nga kjo 131.6 (njëqind e tridhjetë e një, pikë gjashtë) m² ndërtesë. Sipas ZVRPPSH, origjina e kësaj prone është Leja e Legalizimit nr. *** datë 04.12.2012, lëshuar nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Informale, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Shkodër.

Kalimi i të drejtës së pronës së trualli prej 300 m² subjekti të rivlerësimit i është kryer në zbatim të Vendimit nr.513, datë 1.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale” dhe më pas është lidhur kontrata e kalimit të pronësisë me nr. *** rep., nr. *** kol. të noterisë Shkodër.

Vlera totale e parcelës ndërtimore është vlerësuar 400.000 (katërqind mijë) lekë, nga të cilat 70% janë paguar me bono privatizimi në vlerën 280.000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë dhe 30% ose rreth 120.000 (njëqind e njëzet mijë) janë paguar në lekë.

Konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar një objekt informal gjatë viteve 1993-1995, me sipërfaqe ndërtimi 131,06 m² me një kat ndërtimi. Ky objekt është legalizuar me lejen e legalizimit nr. ***, datë 04.12.2012.

Gjithashtu, Komisioni hetoi mbi të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortes, ku bazuar në analizën financiare që kishte si referim dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit si dhe në provat e administruara nga institucionet publike dhe private, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e truallit dhe ndërtimin e shtëpisë, sipas deklarimeve dhe vërtetimeve të fakteve nga ZVRPPSH.

¹ Nr. ***, datë 10.01.2018 ZVRPP Shkodër ka paraqitur praktikën e disponuar nga kjo zyrë për pronën nr. *** vol. *** fq. *** të ndodhur në ZK nr. *** të llojit truall.

Komisionit, nga analiza e fakteve i rezulton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën vetting dhe deklaramet e bëra me anë të postës elektronike, përputhen me dokumentacionin e administruar nga institucionet publike dhe private në lidhje me faktin dhe burimet e ligjshme.

20. Depozita në bankën Credins, Shkodër, më datë 6.1.2017, nr. llogarie ***, në emër të V.S. Burimi i krijimit - të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes. Vlera 2.393.419,34 lekë. Pjesa takuese 50%.

Hetimi kryesisht i kryer nga Komisioni u përqëndrua në vërtetimin e faktit, analizimin e burimeve të krijimit të kësaj depozite dhe nëse burime e krijimit ishin nga të ardhurat të ligjshme. Credins Bank me shkresën nr. ***, dt. 29.6.2017, konfirmon gjendjen e depozitës në dt. 26.1.2017, në shumën 2.430.042 lekë. Komisioni analizoi burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite, pagat e subejktit të rivlerësimit dhe bashkshortes.

Komisioni hetoi mbi të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkshortes, ku bazuar në analizën financiare që kishte si referim dokumnetacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit si dhe në provat e administruara nga institucionet publike dhe private, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite në vlerën 2.393.419,34 lekë, sipas deklarimeve të subjektit dhe vërtetimit të faktit nga ana e Bankës Credins.

Komisionit, nga analiza e fakteve i rezulton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën vetting dhe deklaramet e bëra me anë të postës elektronike, përputhen me dokumentacionin e administruar nga institucionet publike dhe private në lidhje me faktin dhe burimet e ligjshme, në lidhje me këtë depozitë bankare. Si përfundim, Komisioni bazuar në sa më lart arrin ne përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj depozite, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr.84/2016.

21. Në lidhje me disa dyshime që Komisioni kishte në lidhje me përdorimin e shpeshtë të automjetit me targa ***, që nuk ishte në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, por në pronësi të nipit të subjektit të rivlerësimit z. K.S.

Hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me këtë dyshim, u përqëndrua në verifikimin e pronësisë së këtij automjeti dhe nëse subjekti kishte kryer ndonjë fshehje të këtij aseti.

Për këtë qëllim iu kërkua informacion i detajuar si nga subjektit të rivlerësimit, ashtu edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor mbi pronësinë, llojin dhe vitin e prodhimit të këtij automjeti, si dhe vënia në dispozicion e aktit të përdorimit të tij, nisur edhe nga shpeshtësia e lëvizjeve të subjektit të rivlerësimit me këtë mjet.

Me shkresën nr. ***, datë 16.01.2018 të DPSHTRR është konfirmuar se ky automjet është në pronësi të shtetasit K.S , i cili është dhe nipi i subjektit të rivlerësimit. Më tej, Subjekti i Rivleresimit në përgjigje të pyetjeve shtesë, ka konfirmuar përdorimin e këtij automjeti dhe ka paraqitur kontratë huapërdorje të lidhur përpara noterit, për automjetin e mësipërm në vitin 2015 me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2015 huadhënësi K.S dhe huamarrësit Vatë dhe I.S, ku këta të fundit ishin të lirë ta përdornin këtë automjet brenda dhe jashtë Shqipërisë për një afat prej një viti nga data 18.12.2015-18.12.2016.

Më tej, iu kërkua subjektit të rivlerësimit të paraqiste kontratën e shit-blerjes së këtij automjeti, ku subjekti paraqiti një kontratën me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 19.09.2014, me çmim 200 000 (dyqind mijë)lekë, blerë nga personi ntjetër i lidhur K.S.

Megjithë sa më lart, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë automjet, ka deklaruar nëpërmjet postës elektronike se më datë 09.04.2018 e ka blerë këtë automjet nga nipi i tij, z. K.S, me kontratën e shitblerjes Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.04.2018 duke vënë në dispozicion edhe një dokument të Bankës Intesa San Paolo të llogarisë së bashkëshortes, ku konstatohet tërheqja e shumës prej 409.455 lekë në datë 30.03.2018.

Komisionit, nga analiza e fakteve i rezulton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën vetting dhe deklarimet e bëra me anë të postës elektronike, përputhen me dokumentacionin e administruar nga institucionet publike dhe private në lidhje me faktin dhe burimet e ligjshme, në lidhje me përdorimin dhe më tej blerjen e këtij automjeti.

- 22. Në lidhje me pasuri të tjera të fshehura ose të padeklaruara** nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, Komisioni kërkoi informacion pranë të gjitha institucioneve publike dhe private, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016, dhe nga dokumentacioni i administruar, Komisionit nuk i rezultoi se subjekti i rivlerësimit të kishte asete/pasuri të fshehura ose të padeklaruara.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni arrin në përfundimin se Subjekti i Rivlerësimit Vatë Staka, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë duke shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, duke paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e këtyre pasurive dhe të ardhurave.

B. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

- 23.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (“**DSIK**”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.
- 24.** Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se për Subjektin e Rivlerësimit Vatë Staka, nga verifikimet e kryera nuk rezultoi të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, e ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën si dhe ka bërë deklarime të sakta dhe me vërtetësi ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL

- 25.** Prokuroria e Përgjithshme si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka përgatitur një raport, ku janë analizuar të dhënat që kanë rezultuar nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Gjithashtu , ky raport është hartuar bazuar nëpërshkrimin dhe analizimin e:

1. Formularit të vetëdeklarimit,
2. 3(tre) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
3. 5(pesë) dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
4. të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme

26. Rivlerësimi nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Grupi i Punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm;
- Informacione të marra nga burime të ligjshme;
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga analizimi i sa më sipër rezultoi se:

1. Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore - Subjekti i rivlerësimit, Z. Vatë Staka ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme.

Nga vlerësimet e punës së subjektit Vatë Staka për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti Vatë Staka është vlerësuar “shumë mirë” mbështetur në treguesit vjetorë të punës së këtyre viteve.

Arsyetimi ligjor - 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe në 5 dosjet e përzgjedhura për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se subjekti ka aftësi të mjaftueshme në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim relativisht të kuptueshëm.

2. Aftësitë organizative

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura me short për periudhën e vlerësimit Tetor 2013 – Tetor 2016, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së çështjeve që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve përkatëse.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore, rezulton se subjekti i ka kryer hetimet sipas afateve që parashikon neni 323 i Kodit të Procedurës Penale. Në këto procedime penale rezulton se janë kryer në çdo rast procedurat e njoftimit të akteve të prokurorit për palët pjesëmarrëse dhe po

kështu për këto procedime nuk rezulton të ketë patur kontestime apo ankesa prej tyre. Nga ana e subjektit janë lënë detyra të hollësishme dhe të detajuara për oficerët e policisë gjyqësore, të cilët janë orientuar në mënyrë të qartë për hetimet që duhet të kryheshin.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve, për subjektin Vatë Staka nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth etikës në punë dhe cenimit të integritetit të tij.

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin Vatë Staka për periudhën objekt vlerësimi nuk rezulton të ketë patur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar, apo të jenë diskutuar cenimi i të drejtave të pjesëmarrësve në proces, apo të grupeve shoqërore vulnerable. Nuk ka raste për zëvendësimin apo heqjen dorë të prokurorit për arsye të papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në procedim gjatë periudhës së rivlerësimit. Gjithashtu, nuk rezulton se ka hetuar çështje ku ka patur diskriminim apo çështje të barazisë gjinore dhe pakicave.

4. Të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme

Nga verifikimi në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezulton që subjekti Vatë Staka të ketë patur masa disiplinore, apo ndaj tij të jenë depozituar ankesa lidhur me punën e kryer.

V. DENONCIMET NGA PUBLIKU SIPAS NENIT 53 TË LIGJIT NR. 84/2016

Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit janë depozituar 3 ankesa. Denoncimi nr. ***, datë 24.11.2017 i shtetasit G.M dhe nr. ***, datë 12.04.2018 i shtetasit M.T nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin. Lidhur me denoncimin nr. ***, datë 26.01.2018 të shtetasit T.N, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokurori i çështjes penale për të cilën ishte paraqitur ankesa.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisionit i rezulton se Subjekti i Rivlerësimit Vatë Staka, nga vlerësimi i kryer me ndihmën e Grupit të Punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, si organi që ushtron detyrën e vlerësimit në kohën kur po kryhet rivlerësimi, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është i aftë, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

VI. NJOFTIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT DHE VËZHGUESIT TË OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT

Trupa gjyqësore, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko Hrvatini, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Z. Vatë Staka, në seancë dëgjimore në datën 25.06.2018, ora 15:00 paradite, në sallën e Pallatit të Kongreseve, në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

Z. Vatë Staka mori dijeni dhe u paraqit personalisht në seancat dëgjimore të datës 25.06.2018 dhe 03.07.2018.

Ai nuk paraqiti prova apo pretendime gjatë kësaj seance, duke kërkuar rikonfirmimin në detyrë.

Trupa gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se:

Subjekti i rivlerësimit, Z. Vatë Staka ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjyqese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko Hrvatin, dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, , pika 1 e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Z. Vatë Staka, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 03.07.2018.

**KRYESUES
Komisionere**

Valbona Sanxhaktari

**RELATOR
Komisionere**

Etleda ÇIFTJA

**Sekretare gjyqësore
Anisa DUKA**

**ANËTAR
Komisionere**

Xhensila Pine